

AKTI I THEMELIT TË SHOQËRISË

"ERA Medical Services" SHPK

Në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" I ndryshuar si dhe të ligjit 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit" I ndryshuar, unë:

"SFI Holding" shpk me NUIS L91314020A dhe adresë në Rr. Frosina Plaku, nr 36, Tiranë, përfaqësuar nga:

Kristian **Vogeli**, I biri i Hans, shtetas shqiptar, lindur më 22/06/1968 në Herbligen, Zvicër, banues në Tiranë, me letërnjoftim nr.026566550 dhe nr. personal G80622054C, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, në cilësinë e Ortakut të Vetëm dhe Administratorit të Shoqërisë,

shpall si më poshtë vijon:

Neni 1

Sot me 15/01/2019, themelohet shoqëria e quajtur **"ERA Medical Services" shpk** me ortak të vetëm:

"SFI Holding" SHPK me NUIS L91314020A dhe adresë në Rr. Frosina Plaku, nr 36, Tiranë,

Neni 2

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga Frosina Plaku, zona kadastrale 8220, Nr 36, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të themelojë degë dhe filiale në të gjithë territorin e vendit si dhe jashtë tij me miratimin e organeve kompetente dhe në përputhje me legjislacionin e vendit ku do të hapen këto agjensi.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:

Të zhvilloj aktivitet në fushën e shërbimeve mjekësore, duke përfshirë shërbim ambulator, shërbim i mjekut në familje, shërbim transporti mjekësor me mjete dhe staf të specializuar e të

pajisur me aparaturat e nevojshme mjekësore, laborator mjekësor, qendra shëndetësore dhe shërbime të tjera të lidhura me to.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenit 72, të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm."

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përbëhet nga **një kuotë prej 1.000 lekë dhe është kontribut i Ortakut të vetëm:**

"SFI Holding" SHPK me NUIS L91314020A dhe adresë në Rr. Frosina Plaku, nr 36, Tiranë.

Ortakët e shoqërisë mund të vendosin për rritjen e kapitalit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

Detyrimet e çdo ortaku kundrejt shoqërisë përballohen vetëm për pjesën e kapitalit të derdhur nga ai. Për detyrimet e tjera të shoqërisë ortaku nuk mban përgjegjësi.

Neni 6

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga organet e saj të cilat janë:

1. Asambleja e Përgjithshme.
2. Administratorët

Shoqëria ka si ortak të vetëm:

"SFI Holding" shpk me NUIS L91314020A dhe adresë në Rr. Frosina Plaku, nr 36, Tiranë,

Dhe Administrator:

Renato Toska, i biri i Janit, shtetas shqiptar, lindur më 13/07/1981 në Fier , Shqipëri , banues në Tiranë, me letërnjoftim nr.028020266 dhe nr. personal I10713154G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Mënyra dhe drejtimi i shoqërisë janë të përcaktuara në Statutin e shoqërisë.

Neni 7

Ortakët e shoqërisë janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht.

Neni 8

Nëse shoqëria do të likujdohet atëherë do të caktohet një komision likuidimi që do të parashtrojë një bilanc likuidimi për miratim.

Neni 9


Çdo mosmarrëveshje që do të lind në lidhje me këtë marrëveshje apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhet me mirëkuptim dhe do të diskutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje me mirëkuptim të mosmarrëveshjes, çështja do t'i kalojë për gjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

ORTAK I VETËM I SHOQËRISË "ERA Medical Services" shpk

"SFI Holding" shpk

Përfaqësuar nga Administratori Kristian Vogeli



Kristian Vogeli